



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-049

Prishtinë, më 19 nëntor 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 19 NËNTOR 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Kujtim Shala, Aida Dërguti, Slavko Simiq dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Muharrem Nitaj, Sasha Milosavljeviq dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu,

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri (3) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Caktimi i datës për vazhdimin e seancave të papërfunduara,
3. Përgatitjet për seancë plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve, të mbajtura më 29 tetor dhe 7 e 12 nëntor 2018.

* * *

2. Vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme dhe asaj plenare:

Kryetari i njoftoi të pranishmit me ndërprerjen e seancës së jashtëzakonshme, të filluar më 16 nëntor 2018, si dhe me pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të filluara më 13 shtator, më 18, 31 tetor, 2 dhe 7 nëntor 2018,

Kryesia, me propozim të kryetarit, vendosi që seanca e jashtëzakonshme dhe ajo plenare, t'i vazhdojnë punimet të enjten, më 22 nëntor 2018, si në vijim:

1. Vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme, e ndërprerë më 16 nëntor 2018, do të mbahet të enjten, më 22 nëntor 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar sipas kërkesës së 42 deputetëve lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës.

2. Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 13 shtator, më 18, 31 tetor, 2 dhe 7 nëntor 2018, do të mbahet të premten, më 23 nëntor 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës,*
2. *Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore,*
3. *Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,*
4. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës,*
5. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,*
6. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/ L-010 për noterinë,*
7. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,*
8. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-038 për shërbimet postare,*
9. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,*
10. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,*
11. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017,*
12. *Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore,*
13. *Votimi për shkarkimin e z. Shqipërim Pula nga pozita e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare,*
14. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë, propozuar nga GP i PSD-së,*
15. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,*
16. *Emërimi i kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,*
17. *Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Stacionit të Autobusëve në Prishtinë për vitin 2017,*
18. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,*
19. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi,*
20. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017,*
21. *Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2017,*
22. *Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala,*
23. *Kërkesa e GP të PSD-së për caktimin e kryesuesit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë,*
24. *Kërkesa e GP të PSD-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.*

3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet formale për shqyrtim në seancë e re plenare të radhës.

Pas diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e re plenare e radhës të mbahet të enjten, më 22 nëntor 2018, në orën 14:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,*
4. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjykatat,*
5. *Shqyrtimi i dytë i Projekt-kodit Penal i Republikës së Kosovës,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve,*
7. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve,*
8. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë,*
9. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,*
10. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë,*
11. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore,*
12. *Interpelanca e Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë nga GP i PSD-së, në lidhje me vdekjet dhe lëndimet e punëtorëve në vendin e punës,*
13. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peticione,*
14. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,*
15. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,*
16. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,*
17. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,*
18. *Përzgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.*

* * *

Gjithashtu, Kryesia lidhur me pikën 17 të lartshënuar të rendit të ditës, nxori edhe këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga Grupet parlamentare të Kuvendit që para seancës plenare të radhës më 23 nëntor 2018 t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë,

si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për katër (4) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP i LDK-së (kryetarin dhe 1 anëtar); GP i AAK-së (zëvendëskryetarin e parë); GP i Listës serbe (zëvendëskryetarin e dytë); GP i PDK-së (2 anëtarë); GP i LVV-së (2 anëtarë); GP i PSD-së (1 anëtar); GP i Nismës Socialdemokrate (1 anëtar) dhe GP “6+” (1 anëtar).

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

4.1 Njoftimet e delegacioneve të Kuvendit të Kosovës lidhur me vizitat zyrtare të realizuara në Sofje, Bruksel dhe në Tiranë

Kryesia u njoftua me shkrim nga delegacionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës për vizitat zyrtare të realizuara, si në vijim:

1. Delegacioni tre (3) anëtarësh nga Komisioni për Integritet Evropian dhe nga Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike e ka realizuar një udhëtim zyrtar në Sofje (Bullgari), nga 4 - 6 tetor 2018.

2. Delegacioni i përbërë nga tre (3) kryetarë të komisioneve parlamentare: Komisionit për Buxhet dhe Financa, Integritet Evropian dhe atij për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e ka realizuar një udhëtim zyrtar në Bruksel (Belgjikë), nga 10 - 13 korrik 2018.

3. Delegacioni i përbërë nga dy (2) kryetarë të komisioneve parlamentare: Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe atij për Punë të Brendshme, e ka realizuar një udhëtim zyrtar në Tiranë (Shqipëri), nga 25 - 27 shtator 2018.

4.2 Kërkesë për lejimin e vizitës zyrtare në Kuvendin e Kosovës të delegacionit nga Parlamenti i Kroacisë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lejohet vizita e delegacionit pesë (5) anëtarësh nga Komisioni për Çështje Evropiane të Parlamentit të Kroacisë, i cili do ta vizitojë Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga 26 - 28 nëntor 2018.

4.3 Rinovimi i sallës së seancës plenare

Kryetari i njoftoi të pranishmit se ka ankesa nga deputetët e Kuvendit për lëvizjen e tyre në karriget e vendosura afër njëra-tjetrës, si dhe nevojën për vendosjen e një këndi për

mysafirë që marrin pjesë në punimet e Kuvendit. Rinovimi i sallës mund të bëhet me mjetet e Kuvendit dhe me mbështetjen e donatorëve.

Ai hapi diskutimin lidhur me kërkesën e lartshënuar.

Kryesia, pasi diskutoi për rinovimin e sallës së seancës plenare, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Për avancimin e funksionalizimit (ridisenzimi) të sallës së seancës plenare, autorizohet Administrata e Kuvendit që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për planifikimin e buxhetit dhe të shpallë konkurs për hartimin e Projekt-propozimit për rinovimin e sallës së seancës plenare.

2. Projekti për rinovimin e sallës së seancës plenare i dërgohet Kryesisë së Kuvendit, e cila vendos për procedim të mëtejshëm.

4.4 Furnizimi me vetura për anëtarët e Kryesisë së Kuvendit

Kryetari i njoftoi të pranishmit për nevojat e blerjes së veturave për anëtarët e Kryesisë së Kuvendit.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me furnizimin me vetura për anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, mori këtë:

V E N D I M

Furnizimi me automjete (vetura) për anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të bëhet nëpërmjet kontratës për furnizim "Shfrytëzimi afatgjatë i automjeteve me qira, Kategoria III LOT I, numri i prokurimit: AQP 17 006/3-111.

4.5 Kërkesa e Administratës së Kuvendit në lidhje me Projektligjin për pagat në sektorin publik dhe Projektligjin për zyrtarët publikë

Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit në lidhje me tri projektligjet që kanë ardhur nga Qeveria: Ligji për pagat, për organizimin e Administratës dhe për zyrtarët e lartë publikë. Në këto projektligje Administrata e Kuvendit nuk është trajtuar mirë. Me qëllim të ruajtjes së statusit të tanishme, është formuar një grup punues, i cili i ka hartuar disa propozime, të cilat nëpërmjet Kryesisë së Kuvendit do të adresohen në komisionin funksional.

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa gjatë shqyrtimit të Projektligjit për pagat në sektorin publik dhe Projektligjit për zyrtarët publikë duhet ta marrin parasysh natyrën dhe kushtet specifike të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Komisioni Funkcional dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa t'i marrin parasysh propozimet e Administratës së Kuvendit për ta ruajtur strukturën organizative të funksionimit, klasifikimit të pozitive, rekrutimin, orarin e punës, pagën dhe shtesat.

Gjithashtu, Kryesia e Kuvendit, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm, vendosi që të punësuarve në Administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe stafit mbështetës politik për angazhim të shtuar jashtë orarit të punës dhe për performansën e treguar gjatë vitit 2018 në mbështetjen e Kryesisë së Kuvendit, seancës plenare dhe komisioneve parlamentare, t'u bëhet një kompensim shtesë.

5. Të ndryshme

Kryetari i GP të PSD-së, z. Dardan Sejdiu, e shtroi çështjen e funksionimit më të mirë dhe ngritjes së kapaciteteve të shërbimeve të teknologjisë informative.

Nënkryetari i GP të AAK-së, deputeti Muharrem Nitaj, e shtroi shqetësimin për vendosjen e konstruksionit të llamarinave para hyrjes në ndërtesën e Kuvendit.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale